



Republika e Kosovës  
Republika Kosova  
Republic of Kosovo



Zyra Kombëtare e Auditimit  
Nacionalna Kancelarija Revizije  
National Audit Office

## RAPORTI I AUDITIMIT PËR PASQYRAT FINANCIARE VJETORE TË MINISTRISË SË SHËNDETËSISË PËR VITIN 2023

Raporti i nënshkruar nga  
Vlora Spanca,  
Auditore e Përgjithshme

**Prishtinë, maj 2024**

# PËRMBAJTJA E RAPORTIT

- 1 Opinioni i Auditimit
- 2 Gjetjet dhe rekomandimet
- 3 Informacion i përmbledhur për planifikimin dhe realizimin e buxhetit
- 4 Progresi në zbatimin e rekomandimeve

Shtojca I: Letër konfirmimi / Tabela për Komentet e OB-së lidhur me raportin e auditimit

Shtojca II: Shpjegim lidhur me llojet e të ndryshme të opinioneve të aplikuara nga ZKA dhe pjesëve të tjera të Raportit të Auditimit

# 1 Opinioni i Auditimit

Ne kemi përfunduar auditimin e pasqyrave financiare të Ministrisë së Shëndetësisë për vitin e përfunduar më 31 Dhjetor 2023, në përputhje me Ligjin për Auditorin e Përgjithshëm dhe Zyrën Kombëtare të Auditimit të Republikës së Kosovës dhe Standardet Ndërkombëtare të Institucioneve Supreme të Auditimit (SNISA). Auditimi është kryer për të na mundësuar të shprehim opinionin për pasqyrat financiare dhe konkluzionin për pajtueshmërinë me autoritetet.<sup>1</sup>

## Opinion i kualifikuar për pasqyrat financiare vjetore

Ne i kemi audituar pasqyrat financiare vjetore të Ministrisë së Shëndetësisë (MSH), të cilat përmbajnë pasqyrën e pranimeve dhe pagesave në para të gatshme, raportin e ekzekutimit të buxhetit si dhe shënimet shpjeguese për pasqyrat financiare, përfshirë përmbledhjen e politikave të rëndësishme të kontabilitetit dhe raportet tjera<sup>2</sup>, për vitin e përfunduar më 31 dhjetor 2023.

Sipas opinionit tonë, përveç ndikimit të çështjes/ve të përshkruara në paragrafin për Bazën për Opinion të Kualifikuar, Pasqyrat Financiare Vjetore të Ministrisë së Shëndetësisë, prezantojnë një pamje të drejtë dhe të vërtetë në të gjitha aspektet materiale, në përputhje me Standardet Ndërkombëtare të Kontabilitetit për Sektorin Publik, sipas kontabilitetit të bazuar në para të gatshme.

## Baza për Opinion të Kualifikuar

- A1 Detyrimet kontingjente ishin të mbivlerësuara për 54,289€ pasi që në regjistrin e tyre gabimisht ishin përfshirë edhe lëndë ku MSH kishte paditur palët tjera dhe lëndë që ishin të përfunduara me aktvendimet e gjykatave;
- A2 Investimi në vijim ishte mbyllur në vlerë 499,221€ pa u përfunduar i tërë projekti dhe për këtë vlerë pasuria ishte nënvlerësuar në PFV; dhe
- B1 Furnizimet e pasurive nën 1,000€ nuk ishin regjistruar plotësisht në sistemin e-pasuria, duke bërë që ato të jenë të nënvlerësuara për 30,839€.

*Më gjerësisht shih nënkapitullin 2.1 Çështjet që ndikojnë në opinion të auditimit*

Auditimi është kryer në përputhje me Standardet Ndërkombëtare të Institucioneve Supreme të Auditimit (SNISA). Sipas këtyre standardeve, përgjegjësitë tona janë përshkruar më poshtë tek pjesa e raportit 'Përgjegjësitë e Auditorit për Auditimin e Pasqyrave Financiare'. Në përputhje me ONISA-P-10, SNISA 130, Kodin e Etikës së ZKA-së, si dhe kërkesat e tjera relevante për auditimin e PFV-ve të organizatave buxhetore, ZKA-ja është e pavarur nga subjekti i auditimit. Besojmë se dëshmitë e auditimit që kemi marrë janë të mjaftueshme dhe të duhura për sigurimin e bazës për opinion.

## **Konkluzion për pajtueshmërinë**

Ne kemi audituar nëse proceset dhe transaksionet përcjellëse janë në pajtueshmëri me kriteret e përcaktuara të auditimit që burojnë nga legjislacioni i zbatueshëm për subjektin e audituar në kontekstin e përdorimit të burimeve financiare.

Sipas konkluzionit tonë, transaksionet e kryera në procesin e ekzekutimit të buxhetit të MSH kanë qenë, në të gjitha aspektet materiale, në pajtueshmëri me kriteret e përcaktuara të auditimit që burojnë nga legjislacioni i zbatueshëm për subjektin e audituar në kontekstin e përdorimit të burimeve financiare.

Pajtueshmëria e transaksioneve dhe prokurimit të kategorive mallra dhe shërbime si dhe investime kapitale janë audituar veçmas për vitin 2023 dhe nuk janë pjesë e këtij raporti. Konkluzioni për pajtueshmëri për këto dy kategori, do të paraqiten në një raport të veçantë të auditimit të pajtueshmërisë.

## **Baza për konkluzion**

Auditimi është kryer në përputhje me Standardet Ndërkombëtare të Institucioneve Supreme të Auditimit (SNISA). Sipas këtyre standardeve, përgjegjësitë tona janë përshkruar më poshtë tek pjesa e raportit 'Përgjegjësitë e Auditorit për Auditimin e Pasqyrave Financiare'. Në përputhje me ONISA-P-10, SNISA 130, Kodin e Etikës së ZKA-së, si dhe kërkesat tjera relevante për auditimin e PFV-ve të organizatave buxhetore, ZKA-ja është e pavarur nga subjekti i auditimit. Besojmë se dëshmitë e auditimit që kemi marrë janë të mjaftueshme dhe të duhura për sigurimin e bazës për konkluzion.

## **Përgjegjësitë e Menaxhmentit dhe të organeve drejtuese/qeverisëse për pasqyrat financiare vjetore**

Sekretari i Përgjithshëm është përgjegjës për përgatitjen dhe prezantimin e drejtë të Pasqyrave Financiare sipas Standardeve Ndërkombëtare të Kontabilitetit në Sektorin Publik - Raportimi Financiar bazuar në Kontabilitetin e Parasë së Gatshme. Po ashtu, Sekretari i Përgjithshëm është përgjegjës edhe për vendosjen e kontrolleve të brendshme, të cilat i përcakton si të nevojshme për të mundësuar përgatitjen e Pasqyrave Financiare, pa keq deklarime materiale të shkaktuara, qoftë nga mashtrimi apo gabimi. Kjo përfshinë përmbushjen e kërkesave që burojnë nga Ligji nr. 03/L-048 për Menaxhimin e Financave Publike dhe Përgjegjësitë dhe Rregullorja nr. 01/2017 për Raportim Vjetor Financiar nga Organizata Buxhetore.

Ministri është përgjegjës për të siguruar mbikëqyrjen e procesit të raportimit financiar të Ministrisë së Shëndetësisë.

## **Përgjegjësia e Menaxhmentit për Pajtueshmërinë**

Menaxhmenti i Ministrisë së Shëndetësisë është gjithashtu përgjegjës për përdorimin e burimeve financiare të Ministrisë së Shëndetësisë në përputhje me Ligjin për Menaxhimin e Financave Publike dhe Përgjegjësinë dhe të gjitha rregullat dhe rregulloret e tjera të zbatueshme.<sup>3</sup>

## **Përgjegjësia e Auditorit të Përgjithshëm për auditimin e PFV-ve**

Objektivat tona janë të ofrojmë siguri të arsyeshme nëse pasqyrat financiare si tërësi nuk përmbajnë keq-deklarime materiale, qoftë për shkak të mashtrimit ose gabimit dhe të hartojmë një raport të auditimit që përfshin opinionin tonë. Siguria e arsyeshme është siguri e nivelit të lartë, por nuk është një garanci se një auditim i kryer në përputhje me SNISA-t do të zbulojë çdo keq-deklarim material që mund të ekzistojë. Keq-deklarimet mund të vijnë nga mashtrimi ose gabimi dhe konsiderohen materiale nëse, individualisht ose si tërësi, në mënyrë të arsyeshme pritet të ndikojnë në vendimet ekonomike të përdoruesve të marra në bazë të këtyre pasqyrave financiare.

Objektivi ynë është gjithashtu të shprehim një konkluzion të auditimit për pajtueshmërinë e autoriteteve përkatëse të Ministrisë së Shëndetësisë me kriteret e përcaktuara të auditimit që burojnë nga legjislacioni i zbatueshëm në kontekstin e përdorimit të burimeve financiare, lidhur me subjektin e audituar.

Si pjesë e auditimit në përputhje me Ligjin për ZKA dhe SNISA-të, ne ushtrojmë gjykim dhe skepticism profesional gjatë gjithë auditimit. Ne gjithashtu:

- Identifikojmë dhe vlerësojmë rreziqet e keq-deklarimit material të pasqyrave financiare, qoftë për shkak të mashtrimit ose gabimit, hartojmë dhe kryejmë procedurat e auditimit që i përgjigjen atyre rreziqeve, dhe marrim dëshmi të auditimit që janë të mjaftueshme dhe të përshtatshme për të siguruar bazën për opinion. Rreziku i mos zbulimit të një keq-deklarimi material që rezulton nga mashtrimi është më i lartë sesa për atë që rezulton nga gabimi, pasi mashtrimi mund të përfshijë manipulim, falsifikim, lëshime të qëllimshme, keq përfaqësime ose anashkalim të kontrolleve të brendshme.
- Identifikojmë dhe vlerësojmë rreziqet e mos-pajtueshmërisë me autoritetet, qoftë për shkak të mashtrimit ose gabimit, hartojmë dhe kryejmë procedurat e auditimit që janë përgjegjëse ndaj atyre rreziqeve, dhe marrim dëshmi të auditimit që janë të mjaftueshme dhe të përshtatshme për të siguruar bazën për konkluzionin tonë për pajtueshmërinë me autoritetet. Rreziku i mos zbulimit të një rasti të mos pajtueshmërisë me autoritetet që vjen nga mashtrimi është më i lartë sesa për atë që rezulton nga gabimi, pasi mashtrimi mund të përfshijë manipulim, falsifikim, lëshime të qëllimshme, keq përfaqësime ose anashkalim të kontrollit të brendshëm.
- Sigurohemi ta kuptojmë kontrollin e brendshëm relevant për auditimin, për t'i hartuar procedurat e auditimit që janë të përshtatshme, por jo me qëllim të shprehjes së një opinioni mbi efektivitetin e kontrollit të brendshëm të Ministrisë së Shëndetësisë.
- Vlerësojmë përshtatshmërinë e politikave të kontabilitetit të përdorura dhe arsyeshmërinë e vlerësimeve të kontabilitetit dhe shpalosjet e ndërlidhura të bëra nga menaxhmenti.

- Vlerësojmë prezantimin e përgjithshëm, strukturën dhe përmbajtjen e pasqyrave financiare, përfshirë shpalosjet, për t'u siguruar se pasqyrat financiare paraqesin transaksionet dhe ngjarjet themelore në mënyrë të drejtë dhe të saktë.

Ndër të tjera, ne komunikojmë me menaxhmentin dhe ata që janë përgjegjës për qeverisjen edhe në lidhje me fushëveprimin dhe kohën e planifikuar të auditimit dhe gjetjet e rëndësishme të auditimit, përfshirë ndonjë mangësi domethënëse në kontrollin e brendshëm që ne e identifikojmë gjatë auditimit.

Nga çështjet e komunikuar me menaxhmentin, ne përcaktojmë ato çështje që ishin më të rëndësishme në auditimin e Pasqyrave Financiare të periudhës aktuale dhe që cilësohen si çështje kyçe të auditimit. Raporti i auditimit publikohet në ueb faqen e ZKA-së, me përjashtim të informacioneve që klasifikohen si senzitive apo për shkak të ndalesave të tjera ligjore e administrative, në pajtim me legjislacionin në fuqi.

## 2 Gjetjet dhe rekomandimet<sup>4</sup>

Gjatë auditimit, kemi vërejtur fusha për përmirësim të mundshëm, përfshirë kontrollin e brendshëm, të cilat janë paraqitur më poshtë për shqyrtimin tuaj në formë të gjetjeve dhe rekomandimeve.

Ministria në vitin 2023 ka shpenzuar vetëm 57% të buxhetit final ose 45,490,961€. Në kontekst të sistemeve financiare fusha ku është identifikuar mangësi më e theksuar ishte ajo e pasurive ku kishte nënvlerësim të pasurive kapitale dhe pasuritë jo kapitale si rezultat i mbylljes së parakohshme të investimeve në vijim si dhe mos regjistrimit të tyre në sistemin e-pasuria. Procesi i mbylljes së investimeve në vijim në rastet kur MSH kishte financuar projektet kapitale për Organizatat tjera nuk ishte koordinuar dhe menaxhuar në mënyrën e duhur.

Po ashtu, tek detyrimet kontingjente dhe llogariitë e arkëtueshme si rezultat i regjistrimeve të gabuara apo mos regjistrimit, në pasqyra nuk ishte prezantuar gjendja reale të tyre.

Këto gjetje dhe rekomandime kanë për qëllim të bëjnë korigjimin e nevojshëm të informacionit financiar të paraqitur në pasqyrat financiare, duke përfshirë shpalosjet në formë të shënimeve shpjeguese dhe të përmirësojnë kontrollet e brendshme lidhur me raportimin financiar dhe pajtueshmërinë me autoritetet në lidhje me menaxhimin e fondeve të sektorit publik.

Ky raport ka rezultuar me gjashtë (6) rekomandime, prej tyre katër (4) janë rekomandime të reja dhe dy (2) të përsëritura. Ne do t'i përcjellim (shqyrtojmë) këto rekomandime gjatë auditimit të vitit të ardhshëm.

Derisa për statusin e rekomandimeve të vitit paraprak dhe nivelin e zbatimit të tyre, shih kapitullin 4.

## 2.1 Çështjet që ndikojnë në opinionin e auditimit

### Çështja A1 - Mbivlerësimi i detyrimeve kontigjente

#### Gjetja

Rregullorja e MF-nr. 01/2017 për raportim financiar, neni 3.1.1-Detyrim kontigjent është një detyrim i cili materializohet vetëm pas ndodhjes së disa ngjarjeve të caktuara në të ardhmen. Ne identifikuam se në PFV detyrimet kontingjente ishin të mbivlerësuara për 54,289€ për çështjet si në vijim:

- Në raportin e detyrimeve kontingjente të IKSHPK-së pesë (5) lëndë në vlerë 10,391€ ishin të përfunduara. Gjatë konsolidimit të raporteve të njësisve vartëse për qëllime të PFV-ve të njëjtat ishin përfshirë si detyrime aktive dhe ishin raportuar në PFV; dhe
- Po ashtu, si detyrim kontigjent gabimisht ishin regjistruar edhe dy lëndë në vlerë 43,898€ ku MSH ishte paditëse ndaj palëve tjera.

Kjo kishte ndodhur nga pakujdesia e zyrtarëve përgjegjës për harmonizimin e raporteve nga të gjitha njësitë vartëse të MSH-së për raportim, dhe përfshirja e gabuar e pasurive kontingjente si detyrime kontingjente.

#### Ndikimi

Mos prezantimi i saktë, i drejtë dhe i plotë i detyrimeve kontigjente ka ndikuar në mbivlerësimin e tyre duke krijuar paqartësi për përdoruesit e PFV-ve. Kjo tregon se nuk janë prezantuar drejtë ngjarjet ekonomike të ndodhura gjatë vitit.

#### Rekomandimi A1

Ministri, duhet të siguroj një koordinim më të mirë në mes zyrës ligjore dhe asaj të financave me qëllim që regjistrat e detyrimeve kontigjente të mbahen të saktë dhe të azhurnuar me informatat e reja, në mënyrë që shënimet në PFV të prezantohen të sakta.

#### Përgjigja e menaxhmentit të entitetit (Pajtohen)



**Çështja A2 - Mbyllja e investimit në vijim pa u përfunduar projekti dhe nënvlerësimi i pasurive****Gjetja**

Rregullorja e thesarit nr. 02-2013 për menaxhimin e pasurisë jo financiare në nenin 13 e sqaron procesin e regjistrimit kur OB blenë apo ndërton pasuri jo financiare për organizatat tjera buxhetore. Pika 1, thekson që - Të gjitha transaksionet e krijuara gjatë blerjes apo ndërtimit të pasurisë jo financiare për organizatat tjera buxhetore duhet të regjistrohen në regjistrat e organizatës financuese në kategorinë e investimeve në vijim.

Projekti për QKMF-në e Mamushës në vlerë 791,019€, ishte pjesërisht i regjistruar si pasuri - investim në vijim në vlerë prej 291,798€. Ministria pjesën e projektit prej 499,221€ e ka mbyllur para kohe si investim në vijim përmes Thesarit, duke e larguar nga regjistri i pasurisë së MSH-së. Mbyllja e një pjese të investimit në vijim ishte bërë para kohe pasi që projekti ka përfunduar në fund të vitit 2023 (raporti i komisionit të pranimit teknik 20.11.2023) dhe për këtë shumë është nënvlerësuar pasuria.

Për këtë projekt kishte memorandume bashkëfinancimi në mes MSH-së dhe Komunës por që ato nuk ishin respektuar nga ana e Komunës dhe i tërë obligimi i financimit i kishte mbetur Ministrisë si palë kontraktuese.

Arsyeja e mbylljes ishte fakti që Ministria e ka kryer pjesën e vetë të financimit por që kjo nuk ka ndodhur sepse ajo ka vazhduar ta financoj projektin deri në finalizim.

**Ndikimi**

Mbyllja e investimit në vijim para se projekti të finalizohet nga MSH si financues ka ndikuar në nënvlerësimin e pasurive në PFV, pasi që kjo pjesë e pasurisë nuk ka figuruar fare në regjistrat e SIMFK.

**Rekomandimi A2**

Ministri duhet të siguroj që të gjitha projektet që janë në proces të ndërtimit duhet të mbesin në regjistrat e pasurive si investime në vijim te Organizata financuese deri në finalizimin e tyre me qëllim që vlera e pasurive të jetë e plotë në PFV.

**Përgjigja e menaxhmentit të entitetit (Nuk pajtohen)**

Me gjerësisht shih Shtojcën I

**Çështja B1 - Regjistrimi jo i plotë i pasurive në sistemin e-pasuria****Gjetja**

Sipas nenit 6, pika 3 të rregullores së MF nr. 02-2013 për menaxhimin e pasurisë jo financiare, pasuria kapitale duhet të regjistrohet në SIMFK, ndërsa ajo jo kapitale dhe stoqet në regjistrin e-pasuria. Pasuritë jo kapitale (me vlerë nën 1,000€) ishin të nënvlerësuara për 30,839€ pasi që furnizimet që ishin blerë dhe paguar në vitin 2023 nuk ishin evidentuar në regjistrin e-pasuria. Furnizimet që nuk ishin evidentuar në sistemin e-pasuria ishin si në vijim:

- Furnizim me inventar për Njësinë e Shërbimeve të Burgjeve në vlerë 13,409€;
- Furnizim me pajisje të teknologjisë informative në vlerë të 9,991€; dhe
- Furnizim me pajisje shtëpiake për Njësinë e Shërbimeve të Burgjeve në vlerë 7,439€.

Mangësitë në regjistrimin e pasurive në sistemin e-pasuria ka ndodhur për shkak të mos funksionimit adekuat të kontroleve të brendshme, dhe mos komunikimit të duhur në mes të njësive vartëse në kuadër të MSH-së.

**Ndikimi**

Mungesa e regjistrave të saktë dhe të plotë të pasurive dhe raportimi jo i duhur i tyre pamundëson një menaxhim dhe kontroll efektiv mbi pasuritë nën 1,000€. Si rrjedhojë e këtyre mangësive kemi nënvlerësim të pasurive duke rezultuar në prezantim jo të drejtë të tyre në pasqyrat financiare.

**Rekomandimi B1**

Ministri duhet të sigurojë se të gjitha njësitë brenda MSH-së bashkëpunojnë efektivisht me zyrtarin e pasurisë në mënyrë që të ketë një regjistër të plotë dhe të saktë të pasurive. Po ashtu, duhet shtuar kujdesi gjatë procesit të regjistrimit të pasurive dhe gabimet e evidentuara në regjistrin e pasurive duhet të korrigojnë në mënyrë që vlera e pasurive të jetë reale.

**Përgjigja e menaxhmentit të entitetit (Pajtohen)**

## 2.2 Çështjet tjera të menaxhimit financiar dhe të pajtueshmërisë

### 2.2.1 Investimet kapitale

Buxheti final për investime kapitale ishte 15,987,569€, prej tyre ishin shpenzuar 7,809,761€. Këto kanë të bëjnë me zgjerimin e infrastrukturës për Sistemin Informativ Shëndetësor (SISH), paisje medicinale, ndërtimin e QKMF-ve, etj.

#### Çështja A3 - Pranimi i garancionit bankar jo të plotë

##### Gjetja

Te kushtet e kontratës "Sistemi i mbikëqyrjes dhe paralajmërimit të sëmundjeve", te pika f. garancioni dhe detyrimet, është përcaktuar që kompania implementuese e projektit ka për obligim mirëmbajtjen dhe avancimin e sistemit pas pranimi për periudhën një vjeçare.

Për t'u siguruar që kompania do ta përmbushë obligimin për mirëmbajtjen një vjeçare Ministria ka kërkuar një garancion bankar në vlerën e shpenzimeve të mirëmbajtjes prej 49,843€. Garancionin bankar që kishte ofruar kompania implementuese dhe pranuar nga Ministria kishte vlerën prej 42,240€, me një diferencë prej 7,603€.

Vlen të theksohet se pas konstatimit të kësaj difference, gjatë procesit të auditimit MSH në muajin prill 2024 e ka siguruar garancionin bankar edhe për këtë pjesë.

Kjo ka ndodhë nga pakujdesia e verifikimit të vlerës në momentin e pranimi të garancionit bankar nga menaxheri i kontratës, dhe mos parandalimi nga nivelet tjera të kontrollit.

##### Ndikimi

Në rast të mos përmbushjes së kontratës nga OE, vlera e garancionit bankar nuk e mbulon vlerën e dëmit, e cila mund të ndikoj në përmbushjen e kontratës dhe funksionimin e plotë të sistemit.

##### Rekomandimi A3

Ministri duhet të sigurohet përmes stafit përgjegjës që para se të realizohet pagesa, të verifikohet nëse vlera e garancionit bankar është plotësisht në përputhje me kërkesën.

#### Përgjigja e menaxhmentit të entitetit (Pajtohen)

## 2.2.2 Pasuritë kapitale dhe jokapitale

Vlera e paraqitur në PFV e pasurive kapitale është 13,595,918€, pasurive jokapitale është 983,260€, si dhe e stoqeve 5,754,127€.

### Çështja A4 - Mos ndjekja e procedurave të pranimit dorëzimit të pasurive

**Gjetja** Rregullorja e thesarit nr. 02-2013 për menaxhimin e pasurisë jo financiare në nenin 12 dhe 13 e sqaron procesin e regjistrimit kur OB blen apo ndërton pasuri jo financiare për organizatat tjera buxhetore me financim të plotë apo bashkëfinancim. Pika 2, e këtyre neneve thekson që - në momentin kur pasuria jo financiare i ka kaluar të gjitha rregullat dhe procedurat e dorëzimit, organizata buxhetore financuese do të mbyllë llogarinë e investimeve në vijim, kurse pika 3, thekson që organizata buxhetore pranuese do ta regjistroj në regjistrat e pasurisë jo financiare të saj.

MSH për projektet që i ka financuar i kishte drejtuar Thesarit një kërkesë (mars 2022) për mbylljen e disa projekteve-pasurive jo financiare<sup>5</sup> që ishin të regjistruara si investime në vijim me qëllim që ato të regjistrohen si pasuri në përdorim të përfituesit - OB-të përkatëse. Vlera e tyre ishte 2,371,166€ Thesari e kishte mbyllur kategorinë e investimeve në vijim për këto projekte në SIMFK, por që këto pasuri nuk ishin regjistruar tek Organizatat përfituese. Duhet theksuar që pas mbylljes së investimeve në vijim, MSH-ja si financues (bashkëfinancues) i projekteve e as Thesari që e kishte kryer mbylljen e investimeve në vijim, e cila mandej duhej të regjistrohej si pasuri në përdorim të organizatave përfituese (në këtë rast Komunitat). Si rrjedhojë pasuria është larguar nga regjistri i pasurisë së MSH-së pa i njoftuar OB-të përfituese që ato të bëjnë regjistrimin e pasurive në përdorim.

Mungesa e ndjekjes së procedurave adekuate dhe koordinimit në trekëndëshin MSH si financues - OB si përfituese dhe Thesari që e ka bërë mbylljen e investimeve në vijim ka shkaktuar mbetjen e pasurive jashtë regjistrave të pasurive në SIMFK.

**Ndikimi** Mos ndjekja e të gjitha procedurave për bartjen e objekteve ka ndikuar që pasuritë të mbesin jashtë regjistrave të pasurive në SIMFK si të Organizatave financuese ashtu edhe të ajo përfituese.

**Rekomandimi A4** Ministri duhet të siguroj që të gjitha pasuritë e blera për organizatat tjera përfituese të cilat janë të përfunduara bazuar në raportet e pranimit teknik të barten tek përfituesit përmes një procedure të shkruar dhe një koordinimi të mirë me të gjithë akterët relevant.

### Përgjigja e menaxhmentit të entitetit (Nuk pajtohen)

Me gjerësisht shih Shtojcën I

### 2.2.3 Të arkëtueshmet

Llogaritë e arkëtueshme në PVF për vitin 2023 ishin 1,897,421€. Krahasuar me vitin paraprak vlera e tyre ishte rritur për 923,964€. Kjo rritje vjen kryesisht si rezultat që obligimet që kishin specializantët ndaj MSH-së nuk ishin prezantuar në vitet paraprake.

#### Çështja B2 - Mangësi në menaxhimin e të arkëtueshmëve

##### Gjetja

Udhëzimi Administrativ nr. 05/2017 në nenin 60 pikën 4 ka përcaktuar që për shkollimin specialistik me vetëfinancim (ku specializimi zgjatë 3 vite) pagesa është 500€ në vit. Përderisa çregjistrimi i specializantit (ndërprerja e specializimit) rregullohet me nenin 29 ku theksohet që specializanti që ndërpre në specializimin me vetëiniciativë është i obliguar që te institucioni përkatës të kthej të gjitha pagat e fituara.

Vlera e Llogarive të Arkëtueshme (LI/A) për specializanta e paraqitur në PVF prej 1,051,500€ ishte akumuluar si pasojë e mosinkasimit të borxheve nga specializantët që kryejnë shkollimin në QKUK nga viti 2020 e tutje. Ne identifikuam mangësitë si në vijim:

- Ministria në vitin 2023 i kishte prezantuar si llogari të arkëtueshme vlerat e obligimeve të specializantëve bazuar vetëm në tarifat e përcaktuara sipas udhëzimit. Specializantëve nuk iu kishte lëshuar ndonjë dokument (faturë apo fletëpagesë) për të konfirmuar obligimin që ata kanë ndaj Ministrisë dhe për të krijuar një databazë vjetore të llogarive të arkëtueshme. Po ashtu, ne nuk kemi vërejtur se Ministria kishte dhënë ndonjë vërejtje për mospagesën e specializimit në vitet paraprake. Kushti që Ministria pretendon ta aplikoj për inkasim është që në kohën kur specializanti lajmërohet për paraqitje të provimit specialistik të paguaj borxhin; dhe
- Një specializant kishte kërkuar me vetëiniciativë ndërprerjen e përhershme të shkollimit specialistik në mars të vitit 2022 dhe Bordi për shkollim specialistik ka miratuar këtë kërkesë. Pas kësaj specializanti është dashur t'i kthej 9,462€ para të fituara në emër të pagave gjatë specializimit mjete të cilat ende nuk janë kthyer dhe nuk janë paraqitur si të arkëtueshme. Ministria në vitin 2023 kishte marrë një iniciativë që të kontaktojë rastet e tilla dhe të kërkojë kthim e mjeteve.

Mosdefinimi i qartë përmes faturës/fletëpagesës të obligimeve që kanë specializantatët ndaj Ministrisë ka sjellur një situatë ku nuk kemi asnjë pagesë të këtyre obligimeve deri në fund të vitit 2023.

##### Ndikimi

Mos ndërmarrja e masave konkrete për arkëtimin e borxheve, ndikon në rritjen e llogarive të arkëtueshme dhe rritë rrezikun që ato të vjetërsohen dhe të bëhen te pambledhshme.

##### Rekomandimi B2

Mnistri duhet të sigurojë përmes burimeve njerëzore definimin e qartë të obligimeve të secilit specializant në kontratat e tyre të punës. Po ashtu, departamenti i financave duhet të lëshoj një dokument (faturë, fletëpagesë) në lidhje me obligimin që ka specializanti në përputhje me tarifat në udhëzim.

##### Përgjigja e menaxhmentit të entitetit (Pajtohen)

### 3 Informacion i përmbledhur për planifikimin dhe realizimin e buxhetit

Në këtë kapitull kemi prezantuar një informacion të përmbledhur për burimet e fondeve buxhetore, shpenzimin e fondeve dhe të hyrave të mbledhura, sipas kategorive ekonomike. Kjo është ilustruar përmes tabelave dhe grafikëve të mëposhtëm:

**Tabela 1. Shpenzimet sipas burimeve të fondeve buxhetore (në €)**

Përshkrimi	Buxheti fillestar	Buxheti final <sup>6</sup>	2023 Shpenzimet	2022 Shpenzimet	2021 Shpenzimet
<b>Burimet e fondeve</b>	<b>81,006,876</b>	<b>79,351,719</b>	<b>45,490,623</b>	<b>35,744,066</b>	<b>62,711,491</b>
Grante Qeveritare – Buxheti	57,922,440	47,908,822	38,955,720	28,893,431	35,071,104
Financimi përmes huamarrjes	14,311,619	14,311,619	1,113,828	4,614,822	18,287,772
Financimi përmes huamarrjes – klauzola e investimeve	8,772,818	10,152,190	4,782,498	1,625,114	7,112,780
Donacionet vendore	0	566,444	129,150	0	0
Donacionet e jashtme	0	6,412,644	509,427	610,700	2,239,835

Buxheti final është më i ulët se buxheti fillestar për 1,655,157€. Ky zvogëlim është rezultat i mos shpenzimit të buxhetit në kategoritë ekonomike të investimeve kapitale dhe mallra e shërbime.

Realizimi i ulët i projekteve kapitale dhe furnizimet e ulëta me mallra e shërbime ishte kryesisht i ndikuar nga faktorët që ndërlidhen me planifikimin dhe realizimin e tyre. Faktorët kyç për një nivel të ulët të shpenzimeve ishin përgatitjet jo të duhura të proceseve të prokurimit, mungesa e projekteve ekzekutive për projektet kapitale, mungesa e ofertave të përgjegjshme dhe ankesat e operatorëve në Organin Shqyrtues të Prokurimit (OSHP).

Në vitin 2023 MSH ka shpenzuar 57% të buxhetit final ose 45,490,961€ me një ulje prej 8% në krahasim me vitin 2022. Sidoqoftë, zbatimi i buxhetit mbetet në një nivel të pakënaqshëm dhe shpjegimet për pozicionin aktual janë detajuar më poshtë.


**Tabela 2. Shpenzimet e fondeve sipas kategorive ekonomike (në €)**

Përshkrimi	Buxheti fillestar	Buxheti final	2023 Shpenzimet	2022 Shpenzimet	2021 Shpenzimet
<b>Shpenzimet e fondeve sipas kategorive ekonomike</b>	<b>81,006,876</b>	<b>79,351,719</b>	<b>45,490,623</b>	<b>35,744,066</b>	<b>62,711,491</b>
Pagat dhe mëditjet	11,782,272	13,040,627	13,031,527	10,776,522	11,508,451
Mallrat dhe shërbimet	42,063,633	44,978,370	19,452,122	17,970,476	34,270,481
Komunalitë	281,348	281,348	219,052	182,602	199,977
Subvencionet dhe transferet	4,513,805	5,063,805	4,978,161	3,778,897	4,748,974
Investimet Kapitale	22,365,818	15,987,569	7,809,761	3,035,569	11,983,609

Shpjegimet për ndryshimet në kategoritë e buxhetit janë dhënë më poshtë:

- Buxheti final për paga dhe mëditje krahasuar me buxhetin fillestar ishte rritur për 1,258,355€, me vendime të qeverisë nr. 02/125 dhe 38/178 për pagesat e shtesave të nëpunësve të sistemit shëndetësor dhe për plotësimin dhe ndryshimin e rregullores dhe vendimi nr. 15/121 lidhur me Pakon e Ringjalljes Ekonomike. Buxheti final I kësaj kategorie ishte shpenzuar 99%;
- Buxheti final në mallra dhe shërbime dhe komunalitë ishte rritur për 2,914,737€ në krahasim me buxhetin fillestar, me vendime të qeverisë. Shpenzimet ishin realizuar vetëm 43% e buxhetit final dhe kjo është rezultat i mos realizimit të projekteve të planifikuara që kanë të bëjnë me furnizime me barna nga lista esenciale dhe paisje mjekësore, si dhe projekte të tjera;
- Buxheti final për subvencione dhe transfere krahasuar me buxhetin fillestar ishte rritur për 550,000€, me vendime të qeverisë nr.02/127 për pagesën e 580 specialistëve me vetëfinancim, vendimi nr.03/127 për pagesën e 10 specialistëve me vetëfinancim nga Republika e Shqipërisë, Malit të Zi dhe Maqedonisë së Veriut. Këto shpenzime kryesisht kishin të bënin me pagesat e specialistëve dhe mbështetjen e organizatave jo qeveritare nga sektori i shëndetësisë. Nga buxheti final ishin shpenzuar mbi 98%; dhe
- Buxheti final për investime kapitale krahasuar me buxhetin fillestar ishte zvogëluar për 6,378,249€ me vendime të qeverisë. Shpenzimet kapitale kishin të bënin kryesisht me blerjen e pajisjeve mjekësore, autoambulancave dhe ndërtimeve në infrastrukturën shëndetësore. Shpenzimet kapitale ishin realizuar vetëm 49% në raport me buxhetin final. Mos realizimi i shpenzimeve sipas ndarjes buxhetore ishte si rezultat i mos zhvillimit të procedurave të prokurimit me kohë dhe anulimi i disa procedurave të prokurimit në faza të ndryshme.

Grafiku 1. Shpenzimet sipas kategorive ekonomike për vitin 2023



Të hyrat e realizuara nga Ministria e Shëndetësisë në 2023 ishin në vlerë 6,128,450€. Ato kanë të bëjnë me gjobat nga inspektorati, licenca nga aktivitetet individuale dhe të lira, licenca për produkte medicinale, banderolat, participimet, shtija e shërbimeve dhe inspektimi higjenik sanitar. Ministria nuk ka marrëveshje për shfrytëzimin e të hyrave të realizuara, të hyrat e arkëtuara derdhen në buxhetin e Kosovës.

**Tabela 3. Të hyrat (në €)**

Përshkrimi	Buxheti fillestar	Buxheti final	2023 Pranimet	2022 Pranimet	2021 Pranimet
<b>Totali i të hyrave</b>	<b>6,235,884</b>	<b>6,235,884</b>	<b>6,128,450</b>	<b>5,842,047</b>	<b>5,301,986</b>
Të hyrat jo tatimore	6,235,884	6,235,884	6,127,404	5,836,038	5,296,048
Të hyrat tjera	0	0	1,046	6,009	5,937




## 4 Progresi në zbatimin e rekomandimeve

Raporti i auditimit për PFV-të e vitit 2022 të MSH-së ka rezultuar në shtatë (7) rekomandime kryesore. Ministria kishte përgatitur një Plan Veprimi ku paraqitet mënyra se si do t'i zbatoj rekomandimet e dhëna. Ministria, ka dorëzuar Raportet e Progresit mbi zbatimin e rekomandimeve sipas kërkesave të dalura nga Rregullorja e Punës për zbatimin e auditimit dhe planeve të veprimit.

Deri në fund të auditimit tonë për vitin 2023, pesë (5) rekomandime janë zbatuar dhe dy (2) nuk ishin zbatuar ende, siç është paraqitur në Grafikon 2, më poshtë. Vlen të theksohet se si rezultat i auditimeve të ZKA-së nëpër vite gjendja e klasifikimit të shpenzimeve nga ana e MSH-së është përmirësuar ndjeshëm dhe këtë vit nuk kemi identifikuar gabime të tilla.

Për një përshkrim më të plotë të rekomandimeve dhe mënyrën se si janë trajtuar ato, shihni në Tabelën 4 (ose Tabelën e rekomandimeve).

**Grafiku 2. Progresi në zbatimin e rekomandimeve të vitit paraprak**



**Tabela 4 Përmbledhja e rekomandimeve të vitit paraprak**

Nr	Fusha e Auditimit	Rekomandimet e vitit 2022	Veprimet e ndërmarra	Statusi
1.	Pagat dhe mëditjet	Ministri duhet të ndërmerr të gjitha veprimet për të siguruar monitorim të vazhdueshëm të punonjësve/specializantëve ashtu siç parashihet me aktet ligjore. Duhet të nxirren vendimet e pushimeve të lehonisë në mënyrë që specializanteve mos t'iu mohohet e drejta e kompenzimit të shtesave nga Qeveria. Në rastet e tejkalimeve duhet të aplikohet ndalesa në pagë për të korigjuar dhe evituar dëmtimin e buxhetit për vlerën e tejkualuar.	Gjatë këtij viti ne nuk kemi identifikuar raste të njëjta.	I zbatuar
2.	Mallrat dhe shërbimet dhe komunalitë	Ministri duhet të forcojë kontrollet e brendshme dhe nga zyrtarët përgjegjës të kërkojë zbatimin e procedurave, duke filluar nga iniciimi i shpenzimeve deri në kryerjen përfundimtare të pagesave.	Gjatë auditimit nuk kemi identifikuar çështje të njëjta.	I zbatuar
3.	Mallrat dhe shërbimet dhe komunalitë	Ministri duhet të siguroj që ndarja e detyrave dhe dosja e tenderit të përgatitet në mënyrë të tillë që të mos ketë nevojë të ndryshohen kërkesat gjatë procesit, me propozime të ofertuesve. Po ashtu, vendimet për menaxher të kontratës duhet të autorizohen nga ZKA-së.	Procedurat e prokurimit janë trajtuar në një raport ndamas për pajtueshmëri.	I zbatuar
4.	Investimet kapitale	Ministri duhet të sigurohet përmes menaxherëve përkatës se në rastet kur dështon përmbushja e kontratës nga ana e OE pa ndonjë justifikim të bazuar të aplikohen masat e parapara ndëshkuese sepse këto devijime parandalojnë në arritjen e objektivave të synuara.	Është identifikuar progres në eliminimin e keqklasifikimeve të shpenzimeve. Shumë pagesa janë bërë nga dy kategoritë me qëllim të shmangies së pagesave nga kategoria jo adekuate.	I zbatuar
5.	Investimet kapitale	Ministri duhet të sigurojë që janë ndërmarrë veprimet e nevojshme në mënyrë që shpenzimet të planifikohen në ndarjet adekuate të buxhetit dhe që pagesa dhe regjistrimi i shpenzimeve të bëhet sipas kategorisë.	Është identifikuar progres në eliminimin e keqklasifikimeve të shpenzimeve. Shumë pagesa janë bërë nga dy kategoritë me qëllim të shmangies së pagesave nga kategoria jo adekuate.	I zbatuar
6.	Pasuritë	Ministri duhet të sigurojë se të gjitha njësitë brenda MSH-së bashkëpunojnë efektivisht me zyrtarin e pasurisë në mënyrë që të ketë një regjistër të plotë dhe të saktë të pasurive. Po ashtu, duhet shtuar kujdesi gjatë procesit të regjistrimit të pasurive dhe gabimet e evidentuara në regjistrin e pasurive duhet të korigjohen në mënyrë që vlera e pasurive të jetë reale.	Edhe gjatë këtij viti kemi hasur në dobësi në fushën e pasurisë.	Nuk ka filluar zbatimin

7.	Llogaritë e arkëtueshme	Ministri duhet të sigurojë përmes menaxherit të financave një koordinim më efektiv në mes njësive (programeve) me qëllim që gabimet e tilla të mos përsëriten gjatë përgatitjes së pasqyrave financiare të vitit 2023. Po ashtu, Pasqyrat financiare para se të dorëzohen në Thesar duhet t'i nënshtrohen një rishikimi dhe kontrolli të detajuar nga ana e menaxhmentit.	Janë identifikuar mangësi në të menaxhimin dhe mbledhjen e të arkëtueshmeve, mirëpo vlera e prezantimit të tyre në PFV ishte shumë më e ulët në krahasim me vitin paraprak.	Nuk ka filluar zbatimi
----	-------------------------	---	---	------------------------

Vlora Spanca, Auditore e Përgjithshme



Zukë Zuka, Ndhmës Auditor i Përgjithshëm



Faruk Rrahmani, Drejtor i Auditimit



Kreshnike Haziri-Bublica, Udhëheqëse e ekipit



Antigona Çitaku, Anëtare e ekipit



Luljeta Sylaj, Anëtare e ekipit



## Shtojca I: Letër konfirmimi / Tabela për Komentet e OB-së lidhur me raportin e auditimit

Çështja	Komenti i OB-së	Pikëpamja e ZKA-së
Mbyllja e investimit në vijim pa u përfunduar projekti dhe nënvlerësimi i pasurive	Ministria e Shëndetësisë duke iu referuar nenit 44 të LMFP për mbajtje të regjistrave të vet kontabël ka bërë mbylljen e projekteve dhe ka përditësuar regjistrat kontabël të MSH-së në përputhje me aktet nënligjore siç është përcaktuar në dispozitat në fuqi. Financimi i projektit ka përfunduar në at vit sipas ligjit për ndarjet buxhetore. Me datën 21.11.2023 është bërë raporti i pranimit teknik "Ndërtimi i objektit të QKMF-së" në Mamushë, që në PFV nuk është dashur të reflektohen si pasuri e Ministrisë së Shëndetësisë, pasuria e cekur në raportin e Auditorit të Jashtëm.	Raporti i auditimit e ka trajtuar çështjen e largimit të pasurisë pa u finalizuar objekti i QKMF-së, bazuar në rregulloren e pasurive 02/2013. Komenti i MSH-së citon nenin 44 të LMFP-së që flet për regjistrat kontabël të pasurive në terma të përgjithshëm por jo edhe momentin kur një investim në vijim duhet të kalojë si pasuri në përdorim, të cilën çështje e sqaron rregullorja e pasurive.  <i>Gjetja dhe rekomandimi mbeten të pandryshuara.</i>
Mos ndjekja e procedurave të pranim dorëzimit të pasurive	E njëjta çështje në lidhje me investimet në vijim është trajtuar te A4 Mosndjekja e procedura të pranim-dorëzim të pasurive. Ne iu kemi drejtuar sipas kërkesës në muajin mars 2022 thesarit të Kosovës duke u bazuar me nenin 44 të LMFP ku thesari ka trajtuar shkresën siç është shkruar dhe të njëjten e ka ekzekutuar. Siç edhe është informuar ekipi i juaj që pranimet e pasurive kanë ndodhur nga zyrtarët e komunave përkatëse, ku edhe i kanë dëshmitë me e-mail. Në marrëveshjen e bashkëpunimit për bashkëfinancim është cekur që regjistrimi duhet të bëhet nga komuna në SIMFK.	Nga komenti i OB-së vërehet arsyetimi në lidhje me çështjen e largimit të pasurisë ku ishte financuese (bashkëfinancuese), përderisa raporti i auditimit e ka trajtuar çështjen e largimit të tyre nga MSH pa i njoftuar organizatat përfituese dhe si pasojë e mos komunikimit pasuritë kanë mbetur jasht regjistrat të pasurive në SIMFK.  <i>Gjetja dhe rekomandimi mbeten të pandryshuara.</i>

Leterkonfirmimi

REPUBLIKA E KOSOVËS - REPUBLIC OF KOSOVO ZYRA KOMBËTARE E AUDITIMIT NACIONALNA KANCELARIJA REVIZIJE / NATIONAL AUDIT OFFICE			
29-05-2024			
Nr. Prap. 03	Nr. Prap. 47	Nr. Prap. 677	Nr. Prap. 65

REPUBLIKA E KOSOVËS - REPUBLIC OF KOSOVO QENDRIA E KOSOVËS U. ADA - NATIONAL GOVERNMENT OF KOSOVA BESHIRIA E SHËNDETËSISË - MINISTRIJA TË SHËNDETËSISË / MINISTRY OF HEALTH			
Nr. Prap. Org. / Instit. Org. / Unit. 02	Nr. Prap. Proj. / Pror. Proj. No. 05-3951	Data Datumi 28, 05, 2024	No. faqeve Str. / Stranica -65-
Prishtinë / Pr.			

LETËR E KONFIRMIMIT

Për pajtueshmërinë me gjetjet e Auditorit të Përgjithshëm për vitin 2023 dhe për zbatimin e rekomandimeve përveç qeshjeve të cekura më poshtë

**Për: Zyrën e Kombëtare të Auditimit**

Të nderuar,

Përmes kësaj shkrese, konfirmoj se:

- Kam pranuar draft raportin e Zyrës Kombëtare të Auditimit për auditimin e Pasqyrave Financiare të Ministrisë së Shëndetësisë, për vitin 2023 (në tekstin e mëtejshëm "Raporti");
- Pajtohem me gjetjet dhe rekomandimet e dhëna në draft raportin e auditimit për vitin 2023 tjera përveç qeshjes "A2 Investimet në vijim ishin mbyllur në vlerë prej 499,221.00 Euro pa u përfunduar i tërë projekti dhe për këtë vlerë pasuria ishte nënvlerësuar në PVF". Ministria e Shëndetësisë duke iu referuar nenit 44 të LMFPF për mbajtje të regjistrave të vet kontabël ka bërë mbylljen e projekteve dhe ka përditësuar regjistrat kontabël të MSH-së në përputhje me aktet nënligjore siç është përcaktuar në dispozitat në fuqi. Financimi i projektit ka përfunduar në atë vit sipas Ligjit të për Ndarjet Buxhetore, bashkëlidhur gjeni dëshmitë. P.s me datën 21.11.2023 është bërë Raporti pranimit teknik ndërtimi i objektit të QKMF-së në Mamushë, gjë që në PVF nuk është dashur të reflektohen si pasuri e Ministrisë së Shëndetësisë pasuria e cekuar në raportin e raportit të auditorit të jashtëm.

E njëjta çështje në lidhje me investimeve në vijim është trajtuar edhe të A4 Mos ndejeja e procedurave të pranimit dorësimi të pasurive. Ne iu kemi drejtuar sipas kërkesës së muajit mars 2022 Thesarit të Kosovës duke u bazuar në nenin 44 të LMFPF ku Thesari ka trajtuar shkresën siç është shkruar në shkresën e muajit mars 2022 dhe të njëjtën ka ekzekutuar. Siç edhe është informuar ekipi i juaj që pranimet e pasurive kanë ndodhur nga zyrtarët e komunave përgjegjës ku edhe i kanë dëshmitë me email. P.s edhe në marrëveshjen e bashkpunimit për bashkfinancim është cekur që regjistrimi duhet të bëhet nga komuna në SIMFK Bashkëlidhur gjeni dëshmitë.

P.S, dokumentet e bashkangjitura:

1. Raporti i pranimit
2. Marrëveshja e nënshkruar me komunën e Mamushës,
3. Ligji për ndarjet buxhetore për vitin 2023
4. Shkresën e datës 16.05.2024 për kërkesën për Zyren Komtare të Auditimit

- Mbrenda 30 ditëve nga pranimi i raportit final, do t'ju dorëzoj një plan të veprimit për zbatimin e rekomandimeve, i cili do të përshfijë afatet kohore dhe stafin përgjegjës për zbatimin e tyre.

Dr. Naim Bardhiqi  
Sekretar i përgjithshëm



Data: 27 Maj 2024

## Shtojca II: Shpjegim lidhur me llojet e të ndryshme të opinioneve të aplikuara nga ZKA dhe pjesëve të tjera të Raportit të Auditimit

Raporti i auditorit për pasqyrat financiare<sup>7</sup> duhet të përmbajë një opinion për pasqyrat financiare, bazuar në përfundimet e nxjerra nga dëshmitë e marra gjatë auditimit. Kur auditimi kryhet për të vlerësuar gjithashtu përputhjen me legjislacionin dhe rregulloret e tjera, auditorët kanë një përgjegjësi shtesë për të raportuar për pajtueshmërinë me autoritetet<sup>8</sup>, duke rezultuar me konkluzion mbi pajtueshmërinë.

Për të arritur në përfundimin se një opinion mbi pasqyrat financiare është i modifikuar ose i pa modifikuar, një auditor duhet të sigurohet që rezultatet e auditimit përfshijnë, apo jo, keq-deklarim(e) material(e) ose të përhapur(a), apo të tillë(a) të mundshëm(me), të supozuar në rast kufizimi të fushëveprimit.

Keq-deklarimi është një ndryshim mes shumës së raportuar, klasifikimit, prezantimit ose zbulimit të një zëri të pasqyrës financiare dhe sasisë, klasifikimit, prezantimit ose zbulimit që kërkohet që zëri të jetë në përputhje me kornizën e raportimit financiar në fuqi. Keq-deklarimet mund të vijnë nga gabimi ose mashtrimi.

**(shkëputur nga SNISA 200)**

### **Forma e opinionit**

#### **Opinion i pa-modifikuar**

Formulohet kur nuk janë zbuluar keq-deklarime ose mos-pajtueshmëri; kur janë zbuluar keq-deklarime ose mos-pajtueshmëri, qoftë një i vetëm apo një grumbull, por që nuk është i barabartë me ose nuk e tejkalon nivelin e materialitetit për pasqyrat financiare si tërësi; ose kur keq-deklarimi(et) dhe/ose mos-pajtueshmëria e zbuluar brenda një klase të caktuar transaksionesh nuk është e barabartë me ose e tejkalon nivelin e materialitetit më të ulët të vendosur për këtë klasë të transaksioneve. Formulohet gjithashtu nëse nuk ka kufizim të fushëveprimit ose kur kufizimi i fushëveprimit nuk mund të shpie në shmangie të keq-deklarimit(eve) material(e) dhe/ose mos-pajtueshmërisë(ve).

Kufizimi i fushëveprimit ndodh kur një auditor nuk është në gjendje të marrë dëshmi të mjaftueshme auditimi për të arritur në përfundimin se pasqyrat financiare në tërësi nuk përmbajnë keq-deklarime materiale.

Auditori duhet të japë **opinion të pa-modifikuar** nëse arrin në përfundimin se pasqyrat financiare janë përgatitur, në të gjitha aspektet materiale, në pajtim me kornizën e zbatueshme financiare.

### **Modifikimi i opinionit në raportin e auditorit**

Auditori duhet të modifikojë opinionin në raportin e auditorit nëse konstatohet se, bazuar në dëshmitë e marra nga auditimi, pasqyrat financiare në tërësi nuk përmbajnë keq-deklarime materiale dhe/ose mos-pajtueshmëri, ose nuk është në gjendje të sigurojë prova të mjaftueshme të auditimit për të arritur në përfundimin se pasqyrat financiare në tërësi nuk përmbajnë keq-deklarime materiale dhe/ose mos-pajtueshmëri.

Opinionit i modifikuar mund të jetë:

- I kualifikuar,
- I kundërt, ose
- Mohim opinionit

### **Opinionit i kualifikuar**

Formulohet kur janë zbuluar keq-deklarime dhe/ose mos-pajtueshmëri, qoftë një i vetëm apo një grumbull, që janë të barabartë me ose e tejkalojnë nivelin e materialitetit për pasqyrat financiare si tërësi; ose kur keq-deklarimi dhe/ose mos-pajtueshmëria e zbuluar brenda një klase të caktuar transaksionesh është i barabartë me ose tejkalon nivelin e materialitetit më të ulët të vendosur për këtë klasë të transaksioneve. Formulohet gjithashtu nëse ka kufizim të fushëveprimit, i cili mund të mos shpie në shmangie të keq-deklarimit(eve) material(e).

### **Opinionit i kundërt**

Formulohet kur janë zbuluar keq-deklarime dhe/ose mos-pajtueshmëri, qoftë një i vetëm apo një grumbull, që tejkalon në mënyrë të përhapur nivelin e materialitetit për pasqyrat financiare si tërësi; ose kur keq-deklarimet dhe/ose mos-pajtueshmëritë e zbuluara brenda një klase të caktuar transaksionesh e tejkalojnë në mënyrë të përhapur nivelin e materialitetit më të ulët të vendosur për këtë klasë të transaksioneve.

“E përhapur” është term që përdoret, në kontekstin e keq-deklarimeve dhe/ose mos-pajtueshmërive, për të përshkruar efektet e keq-deklarimeve dhe/ose mos-pajtueshmërisë në pasqyrat financiare; ose efektet e mundshme në pasqyrat financiare të keq-deklarimeve dhe/ose mos-pajtueshmërisë, nëse ka të tilla, që nuk zbulohen për shkak të pamundësisë për të marrë dëshmi të mjaftueshme e të duhura të auditimit. Efektet e përhapura në pasqyrat financiare janë ato që, sipas gjykimit të auditorit:

- a) Nuk kufizohen vetëm në elemente, llogari ose zëra të veçantë të pasqyrave financiare;
- b) Por nëse kufizohen si të tilla, përfaqësojnë ose mund të përfaqësojnë një pjesë të konsiderueshme të pasqyrave financiare; ose
- c) Për sa i përket shpalosjeve, janë thelbësore që përdoruesit të kuptojnë pasqyrat financiare.



**Mohim i opinionit**

Formulohet kur kufizimi i fushëveprimit, d.m.th. kur pamundësia për të siguruar prova të mjaftueshme të përshtatshme të auditimit, është i natyrës materiale dhe pervazive.

**Paragrafët e Theksimit të Çështjes dhe paragrafët e Çështjeve të Tjera në raportin e auditorit**

Nëse auditori e konsideron të nevojshme të tërheqë vëmendjen e përdoruesve në një çështje të paraqitur ose shpalosur në pasqyrat financiare, e cila është sa e rëndësishme aq edhe thelbësore që ata të kuptojnë pasqyrat financiare, por ka dëshmi të mjaftueshme e të përshtatshme se çështja nuk përmban keq-deklarime materiale në pasqyrat financiare, auditori duhet të përfshijë paragrafin e Theksimit të çështjes në raportin e tij. Paragrafi për Theksimin e Çështjes duhet t'i referohet vetëm informacionit të paraqitur ose shpalosur në pasqyrat financiare.

Paragrafi i theksimit të çështjes duhet:

- të përfshihet menjëherë pas opinionit;
- të ketë titullin 'theksim i çështjes' ose ndonjë titull tjetër të përshtatshëm;
- të përmbajë një referencë të qartë ndaj çështjes që theksohet dhe të tregojë se në ç'pjesë të pasqyrave financiare mund të gjenden shpalosjet relevante që e përshkruajnë plotësisht çështjen; dhe
- të tregojë se opinionit i auditimit nuk është modifikuar për sa i përket çështjes të theksuar.

Nëse auditori e konsideron të nevojshme të komunikojë një çështje, përveç atyre që janë paraqitur ose shpalosur në pasqyrat financiare, e cila, në gjykimin e auditorit, është e rëndësishme për përdoruesit në mënyrë që të kuptojnë auditimin, përgjegjësitë e auditorit apo raportin e auditimit, dhe me kusht që kjo nuk është e ndaluar me ligj ose rregullore, duhet të përpilohet një paragraf me titullin "Çështje të tjera", apo ndonjë titull tjetër të përshtatshëm. Ky paragraf duhet të paraqitet menjëherë pas opinionit dhe pas çdo paragrafi të Theksimit të çështjes.

## Shënimet fundore

- <sup>1</sup> Pajtueshmëria me autoritetet – pajtueshmëria me të gjitha ligjet, rregullat, rregulloret, standardet dhe praktikatat e mira relevante në sektorin publik
- <sup>2</sup> Raportet tjera janë kërkesë e nenit 8 të së Rregullores 01/2017 për Raportim Vjetor Financiar
- <sup>3</sup> Kolektivisht të referuara si pajtueshmëri me autoritetet
- <sup>4</sup> Çështja A dhe Rekomandimi A - nënkupton çështjet dhe rekomandimet e reja  
Çështja B dhe Rekomandimi B - nënkupton çështjet dhe rekomandimet e përsëritura  
Çështja C dhe Rekomandimi C- nënkupton çështjet dhe rekomandimet pjesërisht të përsëritura.
- <sup>5</sup> QKMF-Gjilan; QKMF- Deçan; QMF Strelc-Deçan; Objekti i urgjencës –Podujevë; QKMF-Gjakovë dhe Renovimi i tri reparteve në spitalin e Gjakovës
- <sup>6</sup> Buxheti Final – buxheti i aprovuar nga Kuvendi i përshtatur më pas nga Ministria e Financave
- <sup>7</sup> Pasqyrat financiare në sektorin publik përfshijnë po ashtu edhe pasqyrën(at) e ekzekutimit të buxhetit
- <sup>8</sup> Pajtueshmëria me autoritetet: pajtueshmëria me ligjet, rregulloret, standardet, apo praktikatat e mira.